

UDHËTIMI I SHTETASVE TË HUAJ ME AUTOKAMPE DHE RIMORKIO TË TËRHEQURA PREJ TYRE

I-BAZA LIGJORE

"Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", neni 61, pika 3 e Ligjit Nr.8378, datë 22.07.1998, i ndryshuar, Neni 183, pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 e ne vijim

II-PËRMASAT GABARITE KUFITARE TË AUTOKAMPEVE

- ❖ Gjatësia e autokampeve nuk mund të jetë më e madhe se 8 metra, ndërsa gjatësia e rimorkiove kamp, duke përfshirë dhe mekanizmin e tërheqjes, nuk mund të jetë më e madhe se 6.50 metra, kur janë me 1 (një) aks dhe 8 (tetë) metra kur janë me 2 (dy) akse.
- ❖ Gjeresia e autokampeve dhe rimorkiove kamp, nuk duhet të jetë më e madhe se 2.55 metra dhe lartësia maksimale nga toka, nuk duhet të kalojë 1.8 herë largësinë minimale (në aksin tërthor), ndërmjet rrotave të mjetit.

III- QARKULLIMI DHE QËNDRIMI I AUTOKAMPEVE

- ❖ Mjetet (autokampet) për qarkullimin rrugor në përgjithësi dhe për shkak të ndalimeve dhe kufizimeve të parashikuara në legjislacion, i nënshtrohen të njëjtës disiplinë të parashikuar për mjetet e tjera.
- ❖ Qëndrimi i autokampeve, aty ku lejohet, në zonën rrugore, nuk përbën kampim, në qoftë se automjeti nuk mbështetet në terren, përveçse me rrotat, nuk lëshon rryma të tjera shkarkimi, përveçse ato të propulsorit mekanik, dhe nuk zë sidoqoftë zonën rrugore në masë më të madhe se madhësia e mjetit.
- ❖ Në rast qëndrimi ose parkimi me pagesë, për autokampet zbatohen tarifa 50% më të mëdha se ato të zbatuara për autoveturat, në parkime të së njëjtës zonë.
- ❖ Ndalohet shkarkimi dhe autokampi i mbetjeve organike dhe i ujërave të pastra dhe të ndotura në rrugë dhe në zona publike jashtë impianteve të caktuara të shkarkimeve higjieniko-shëndetësore.

Për informacion më të plotë dhe të detajuar mund të konsultohen me bazën ligjore: Neni 61 dhe 184 i Ligjit Nr.8378, date 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.